



KËSHILLI PËR ETIKË NË
MEDIA NË MAQEDONI



KUNDËR DISKRIMINIMIT ME PËRFSHIRJE MË TË MADHE NË MEDIA

Shkurt 2021

PËRMBAJTJA

HYRJE	3
PUBLIKIM: GJUHA E URREJTJES - KORNIZA LIGJORE NDËRKOMBETARE DHE KOMBETARE, ME QASJE TË VEÇANTË NDAJ MEDIAVE	4
DEBAT: SI KRIZA ME KORONA VIRUSIN E GODITI GAZETARINË DHE VET -RREGULLIMIN?	6
DEBAT: GJUHA E URREJTJES DHE PRAKTIKAT DISKRIMINUESE NË RAPORTIMIN MEDIATIK	9
DEBAT: ARSIMI DHE MEDIAT NË PËRBALLJEN ME DISKRIMINIMIN, GJUHËN E URREJTJES DHE STEREOTIPAT	14
DEBAT: BASHKËPUNIM PËR ADRESIM EFEKTIV TË PROBLEMIT ME GJUHËN E URREJTJES DHE DISKRIMINIMIT NË MEDIAT	18
PUNËTORI	22

Pergatitur nga



**KËSHILLI PËR ETIKË NË
MEDIA NË MAQEDONI**

www.semm.mk,
info@semm.mk

Bul. „Mitropolit Teodosij Gologanov“
54/2, Maqedonia e Veriut,
00389 02 3222 595

Canada

Ky publikim është përgatitur me mbështetjen e *Fondit Kanadez për Iniciativa* Lokale përmes Ambasadës së Kanadasë. Qëndrimet dhe mendimet e shprehura në publikim, nuk i pasqyrojnë çdoherë qëndrimet dhe mendimet e donatorit.



KEMM është shfrytëzues i grantit institucional nga programi Civica Mobilitas.

Promovimi i standardeve gazetareske profesionale dhe etike dhe mbështetja e vetë-rregullimit në mediat, kontribuojnë në forcimin e luftës kundër diskriminimit dhe gjuhës së urrejtjes në raportimin e mediave. Monitorimi i përdorimit të standardeve profesionale në raportimin e mediave është një nga qëllimet thelbësore të Këshillit të Etikës në Mediat e Maqedonisë (KEMM), i cili u mundëson qytetarëve që kanë konfirmuar mospërputhje dhe gabime në raportimin gazetaresk të ankohen kundër mediave që e kanë bërë këtë gjë.

Projekti *“Promovimi i gjithë-përfshirjes dhe respektimit të të drejtave të njeriut në mediat në Maqedoninë e Veriut”* vendosi një fokus të fuqishëm në ngritjen e vetëdijes dhe përmirësimin e njohurive dhe aftësive rreth nevojës për përballjen me diskriminimin, dezinformatat dhe gjuhën e urrejtjes në mediat. Më shumë se 120 përfaqësues të mediave, organizatave qytetare, institucioneve shtetërore, si dhe qytetarë, morën pjesë në katër debatet dhe dy trajnimet, të organizuara në kuadër të projektit. Diskutuan mbi rëndësinë e vetë-rregullimit dhe përfshirjes në sferën e medias dhe mbi qasjet me të cilat mundet bashkërisht të mbështesin luftën kundër diskriminimit. Në trajnimet, nga ana tjetër, mësuan qasjet për njohjen e gjuhës diskriminuese dhe të urrejtjes në media, si dhe për ndërtimin e strategjive për veprim efektiv kundër praktikave të tilla. Me projektin u mbështet edhe botimi i publikimit *“Gjuha e urrejtjes, korniza ligjore ndërkombëtare dhe kombëtare, me qasje të veçantë ndaj mediave”*, që paraqet një analizë të politikave për mbrojtje dhe parandalim nga diskriminimi dhe për rregullimin e sferës mediatike.

Ky publikim përmbledh aktivitetet e realizuara dhe përmban konkluzionet dhe rekomandimet kryesore që rezultuan nga projekti *“Promovimi i gjithë-përfshirjes dhe respektimit të të drejtave të njeriut në mediat në Maqedoninë e Veriut”*, të cilin Këshilli i Etikës në Mediat e Maqedoni e zbatoi në periudhën 01.07.2020 - 28.02 .2021, me mbështetje të Fondit Kanadez për Iniciativa Lokale.

PUBLIKIM: GJUHA E URREJTJES - KORNIZA LIGJORE NDËRKOMBETARE DHE KOMBETARE, ME QASJE TË VEÇANTË NDAJ MEDIAVE

Në dy dekadat e fundit, termi “gjuhë e urrejtjes” është bërë koncept dominues për shënimin e formave të ndryshme të shprehjeve diskriminuese, përfshirë shprehjet që nxisin dhunë ndaj pjesëtarëve të grupeve të caktuara të definuara në baza racore, fetare, etnike ose të tjera, shprehje që propagandojnë ide për epërsi identitare të një grupi ndaj të një tjetri, shprehje që përfshijnë fyerje të rënda, poshtërim ose çfarëdo shprehje tjetër të abuzimit drejtë individëve ose grupeve të përcaktuara mbi një bazë të veçantë identiteti. Termi “gjuhë e urrejtjes” i referohet një numri të madh të veprimesh të ndryshme që mund të jenë lëndë e sanksioneve sipas ligjit administrativ ose penal, ndërsa masat mund të vijnë nga rregullatorë të ndryshëm (për media, për barazi, diskriminim, etj.).

Konkluzionet kryesore në botim “Gjuha e urrejtjes, korniza ligjore ndërkombëtar dhe kombëtare, me qasje të veçantë ndaj mediave”.

E drejta e lirisë së të shprehurit nuk është e pakufizuar.

Janë paraparë kufizime aq sa është e nevojshme me të drejtën e shprehjes së lirë, në mënyrë që të mos cenohen të drejtat e të tjerëve. Kjo paraqet ekuilibrin themelor midis të drejtës së shprehje së lirë dhe të drejtës së njerëzve të tjerë që të mos dëmtohen nga shprehja e lirë e dikujt.

Ligji për parandalim dhe mbrojtje nga diskriminimi është një mundësi e mirë për iniciuar raste dhe për të aktivizuar instancat gjyqësore.

Në veçanti, dispozitat që kanë të bëjnë me mundësinë e fillimit të një ankese gjyqësore në procedurë civile, kur mungojnë masat që institucionet duhet t'i ndërmarrin sipas detyrës zyrtare.

Nevojitet intensifikim i përpjekjeve për ndërtimin e vetëdijes dhe kapaciteteve tek qytetarët për njohjen dhe reagim ndaj gjuhës së urrejtjes, si dhe për nxitjen e proaktivitetit në lidhje me raportimin e rasteve të gjuhës së urrejtjes në mediat.

Ekziston një gamë e gjerë masash për sanksionimin e gjuhës së urrejtjes.

Megjithatë, nuk ka asnjë tregues se rregullimi penal-juridik ka përmirësuar përballjen me gjuhën e urrejtjes. Për incidente të përditshme, ndoshta është e nevojshme të hulumtohen mundësitë që i ofron sanksionimi i kundërvajtjes, përmes sanksioneve reale në para (ose të tjera), kur konteksti i incidentit (kryesi, rreziku, ndikimi, etj.) nuk është i mjaftueshëm për sanksionimin penal-juridik. Duhet të përmirësohet praktika e sanksionimit.

ASHMAA dhe Avokati i Popullit kanë mundësi të kufizuara për shpartallimin e gjuhës së urrejtjes në media.

Avokati i Popullit nuk ka autorizime të drejtpërdrejta për të vepruar në lidhje me akte konkrete të gjuhës së urrejtjes në media, por është i nevojshëm një angazhim shtesë lidhur me monitorimin dhe inkurajimin e angazhimit institucional. ASHMAA monitoron punën e radiodifuzerëve dhe në këtë drejtim nuk ka mundësi të mjaftueshme për reagim kur ekziston nevoja për të parandaluar “gjuhën e urrejtjes”.

Mundësia për të ngritur një kallëzim për kundërvajtje do të kishte efekt kur Prokuroria dhe gjykatat do të vepronin në lidhje me denoncimet.

Nevojitet një proaktivitet më i madh në Prokurorinë Publike në lidhje me veprimin rreth denoncimeve për gjuhë të urrejtjes në mediat. Gjyqësori duhet të ndjekë praktikën e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut dhe t’i marrë parasysh në sjelljen e vendimeve për raste të caktuara, sepse praktika gjyqësore është jashtëzakonisht e vogël.

ГОВОР НА ОМРАЗА

МЕЃУНАРОДНА И
НАЦИОНАЛНА ПРАВНА
РАМКА, СО ПОСЕБЕН
ОСВРТ НА МЕДИУМИТЕ

DEBAT: SI KRIZA ME KORONA VIRUSIN E GODITI GAZETARINË DHE VET -RREGULLIMIN?

Reporterët pa Kufij, në Indeksin e tyre për Lirinë e Medias të vitit 2020, konstatuan se dekada e ardhshme do të jetë thelbësore për të ardhmen e gazetarisë, me ç'rast pandemia e Covid-19 do t'i theksojë krizat e shumta në lidhje me lirinë e shprehjes dhe plasimin e informacioneve të besueshme, të llojllojshme dhe të balancuara.

Kjo ishte edhe sfida në punën e KEMM vitin e kaluar, kur reagimet dhe ankesat më të shpeshta ishin ato që kishin të bënin me raportimin mediatik për pandeminë. Më shpesh, shkelej neni 1 i Kodeksit të Gazetarëve të Maqedonisë, që ka të bëjë me publikimin e informacioneve të sakta dhe të verifikuara.

Gazetarët u përballën me rrezikun e daljes në terren dhe të raportohej, ndërsa sfida ishte edhe të mbrohej publiku nga lajmet e rreme që përhapeshin shumë shpejt dhe bënin dëme të mëdha, veçanërisht në fillim të krizës, kur shkenca dhe autoritetet shëndetësore nuk kishin përgjigje të sigurt për virusin. Ndikimet e pandemisë ndaj gazetarisë u zhvilluan kryesisht në katër nivele: teknike, thelbësore, respektivisht ndaj përmbajtjeve gazetareske, kondicionit psiko-fizik të gazetarëve dhe gjendjes ekonomike të gazetarëve.

Për sa i përket mbrojtjes dhe ndihmës së redaksive në krizë, ekzistonin mekanizma të brendshëm dhe të jashtëm. Mekanizmat e brendshëm ishin ato që implementonte menaxhmenti i mediave, me qëllim të



mbrojtjes së gazetarëve dhe të punonjësve mediatik për sa i përket rrezikut shëndetësor dhe ndihmës ekonomike dhe sociale, ndërsa mekanizmat e jashtëm pa ato të ndërmarra nga Qeveria dhe institucionet e tjera resorë, por edhe organizatat civile, bashkësia ndërkombëtare, qytetarët, si dhe sektori i korporatave për ndihmë të mediave dhe të gazetarëve.

Këto janë disa nga pikat e debatit “Si kriza me korona virusin e goditi gazetarinë dhe vet-
rregullimin” që u mbajt më 27 gusht të vitit 2020.

[Shikoni pikat nga debati](#)



“Mediave iu bë thirrje të sillen me profesionalizëm dhe me etikë dhe të mos kontribuojnë në përhapjen e të pavërtetave dhe krijimin e panikut tek opinioni. U theksua se informimi në raste të tilla, sipas Kodeksit të gazetarëve (neni 8), duhet të jetë i çliruar nga sensacionet. Mediat duhet të veprojnë në mënyrë që i dallon nga bartës të zakonshëm të informatave dhe të fakteve dhe ta zbatojnë edhe rolin e tyre si qetësues të shqetësimi tek qytetarët”.

Mirçe Adamçevski, kryetar i Komisionit për Ankesa pranë KEMM



“

“Në fillim të krizës, redaksitë nuk ishin të gatshme të punonin në kushte krize të shkaktuar nga pandemia për shkak të mungesës së protokolleve dhe të praktikës paraprake. Për vet gazetarët, problem ishte siguria personale dhe siguria e më të afërmve, shkelja e të drejtave të punëtorit, stresi emocional dhe zvogëlimi i qasjes së informacioneve nga institucionet publike”.

Dragan Sekullovski, Shoqata e Gazetarëve të Maqedonisë

“U humb ndjenja aq e rëndësishme për punë ekipore, që është baza e gazetarisë. Videot arrinin në email, inkuadroheshim nga zyra. Dhe këtu mungonte interaksioni me bashkëbiseduesin. Ministrat dhe funksionarët u bën më komod në deklaratat dhe në konferencat e shtypit, sepse mungonte interaksioni i drejtpërdrejtë, që është shumë më efektiv për t’u zbuluar e vërteta. E gjithë kjo e shndërroi gazetarinë nga një profesion dinamik në profesion të ngathtë, që u shkonte për shtati atyre që dëshironin të mbesnin larg nga syri i kujdesshëm i opinionit”.

Filjana Koka, gazetare e RTM-së

”

Blogje...



Redaksitë dhe pandemia: presione dhe sfida

Martin Petrovski, jurist dhe bashkëpunëtor i SHGM-së

Pas fillimit të krizës globale të shkaktuar nga pandemia, redaksitë e mediave, si në botë ashtu edhe në shtet, u përballën me sfida të shumta. Duke pasur parasysh përhapjen e shpejtë të Covid-19, udhëheqësia e mediave u gjend përballë sfidës për të marrë vendime për atë se si të mirëmbahet puna e një redaksie, puna e së cilës si pikë e parë bazohet në kontakt me njerëzit, madje edhe në kushte kur ekspertët e shëndetit publik dhe përfaqësuesit qeveritarë imponuan izolimin social.

Vet-rregullimi është pengesa kryesore për raportim jo-etik në kushte krize

Teofil Bllazhevski, gazetar

Lufta kundër lajmeve të rreme kërkon unifikim të komunitetit mediatic. Veprimi i përbashkët i organizatave mediatike dhe të ekspertëve për efektet afatshkurta dhe afatgjata nga lufta kundër lajmeve të rreme dhe informimit tjetër jo-etik të opinionit është domosdoshmëri.



Na nevojiten gazetarë si kurrë më parë

Mr. Dejan Andonov, Instituti i Studimeve të Komunikimit

Pandemia krijoi një nevojë të madhe për lajme dhe vendosi në plan të parë rëndësinë e gazetarisë profesionale dhe qasjen deri te informacionet e verifikuar. Por, me të njëjtën shpejtësi të virusit, po përhapen edhe shumë të pavërteta përmes portaleve onlajn dhe rrjeteve sociale që e bëjnë të vështirë që shoqëria të reagojë siç duhet dhe të përballet me pandeminë. Shëndeti i njerëzve nuk varet vetëm nga mbrojtja shëndetësore, por edhe nga qasja deri te informacionet e sakta në lidhje me kërcënimet nga korona virusi dhe si ta mbrojnë veten, familjen e tyre dhe rrethin e tyre.

DEBAT: GJUHA E URREJTJES DHE PRAKTIKAT DISKRIMINUESE NË RAPORTIMIN MEDIATIK

Këshilli i Etikës së Mediave të Maqedonisë e regjistron gjuhën e urrejtjes përmes mekanizmit të tij më të madh – parashtrimin të ankesave deri te Komisioni i Ankesave. Por, gjithashtu, reagon individualisht, me organizatat e tjera profesionale mediatike, por dhe me organin rregullator - Agjencinë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audio-Vizuale, në rastet e shkeljes së neneve të Kodeksit të Gazetarëve të Maqedonisë dhe shfaqjes së gjuhës së urrejtjes dhe diskriminimit në media në baza të ndryshme.

Këtë e theksoi drejtoresha e KEMM, Marina Tuneva, në fillim të debatit “Gjuha e urrejtjes dhe praktikat diskriminuese në raportimin mediatic – deri ku jemi?”, që u mbajt më 28 shtator të vitit 2020.


Bashkëbiseduesit theksuan se është evidente që gjuha e urrejtjes po zhvendoset nga mediat në rrjetet sociale, më saktësisht në komentet në rrjetet sociale, ku mediat plasojnë përmbajtjet e tyre.

Shpërthimi i krizës globale të shkaktuar nga korona virusi në vitin 2020 në Maqedoninë e Veriut, përkoji me periudhën para mbajtjes së zgjedhjeve parlamentare dhe këto dy tema krijuan një ndërhyrje për përshkallëzimi e dezinformimeve dhe gjuhës së urrejtjes mbi baza politike dhe etnike. Por, gjuha e urrejtjes në bazë të gjinisë është gjithashtu në rritje, veçanërisht në rrjetet sociale. Gratë, fëmijët, personat me aftësi të kufizuara, personat e marginalizuar dhe të zhvendosur, të cilët hyjnë në kategorinë e qytetarëve që u prekën më së shumti nga kufizimet e vendosura për shkak të krizës së koronas, por edhe në periudhën pas përfundimit të tyre, mbetën në hijen e raportimit për korona virusin dhe për zgjedhjet, diskutuan pjesëmarrësit e debatit.

Mediat, në funksionin e tyre themelor që të informojnë, kanë edhe funksionin e raportimit se në shoqëri ekziston gjuhë e urrejtjes. Ajo që nuk guxojnë ta bëjnë mediat është të bëhen burim i urrejtjes, të transmetojnë thirrje të drejtpërdrejta për veprime të dhunshme dhe të raportojnë në mënyrë joprofesionale në rastet kur informojnë për ekzistimin e gjuhës së urrejtjes apo në emisione të drejtpërdrejta.

Gjuha në përditshmëri është plot agresion dhe sjellje që mund të shkaktojë dhunë dhe për këtë arsye, media duhet të kenë një përgjegjësi ndaj audiencës e cila nuk mund të bëjë gjithmonë dallimin midis së mirës dhe së keqes. Detyra e mediave është të prodhojë lajme, me të cilat do të kundërshtojnë gjuhën e urrejtjes dhe dezinformimeve që përhapet onlajn, thanë folësit në debat.





“

“Në periudhën e krizës, përshtypja e vetë gazetarëve është se për personat me aftësi të kufizuara raportohej pak dhe në mënyrë sporadike. Më së shpeshti, informacionet lidhur me personat me aftësi të kufizuara kishin të bënin me masat që i ndërmerre Qeveria në lidhje me këtë kategori të qytetarëve, reagimet ndaj masave nga qytetarët, si dhe informacione nga organizatat e shoqërisë civile për mbështetjen e dhënë personave me aftësi të kufizuara. Megjithatë, bëhej fjalë më së shpeshti për lajme të transmetuara dhe raporte të shkurtra, pa histori personale, analiza të thelluara, të dhëna statistikore që do të tregojnë se cila është gjendja në të vërtetë me këtë kategori të qytetarëve”.

Vesna Nikodinoska, Instituti Maqedonas i Mediave

”



“E drejta kombëtare dhe praktika duhet të bëjë një dallim të qartë midis përgjegjesisë së autorit të deklaratës me gjuhë urrejtjeje nga njëra anë dhe përgjegjesisë së medias dhe profesionistëve të medias për kontributin në shpërndarjen e saj, si pjesë e funksionit të tyre për të paraqitur informacione dhe ide mbi çështje me interes publik, nga ana tjetër. Çdo kufizim i lirisë së shprehjes duhet të jetë rezultat i monitorimit që “duhet të ndjekë mënyrën në të cilën Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut vlerëson nëse ka apo jo nevojë për të kufizuar lirinë e shprehjes në secilin rast veçmas, respektivisht a është kufizimi i lirisë së shprehjes: i parashikuar me ligj, ka një qëllim legjitim dhe është i nevojshëm në një shoqëri demokratike”.

*Emilija Petreska-Kamenjarova,
Agjencia për Shërbime Mediatike Audio dhe Audio-Vizuale*

“Është e nevojshme të hapet një debat edhe me producentët e filmit që prodhojnë seriale televizive, ku vërehen role stereotipi të burrave dhe të grave. Aty hasen gjithashtu stereotipa edhe në raport me grupet e tjera të prekshme. Na mungon debati me të gjithë aktorët, të gjithë faktorët që ndikojnë në procesin e socializimit”.

Snezhana Trpevska, kryetare e Institutit RESIS



Blogje...



Tolerimi i gjuhës së urrejtjes paraqet një shkëndijë lehtë flakëruese

Violeta Çadikovska, gazetare

Mos-sanksionimi i gjuhës së urrejtjes në vend paraqet një sfidë serioze për të parandaluar përhapjen e saj. Rrjetet sociale dhe mediat onlajn kanë intensifikuar ndikimin në përhapjen e gjuhës së urrejtjes dhe diskriminimit, në një kohë kur bota po përballet me pandeminë e Covid -19.pandemic.

Problemet e personave të marginalizuar gjatë krizës së koronës u humbën në figurën e madhe të lajmeve të frikshme

Zoran Andonov, gazetar

Këto ditë më takoi një nënë e një fëmije me paralizë cerebrale, anëtare e shoqatës nga Tetova dhe më pyet nëse këta fëmijë do të marrin ndonjë gjë me masat më të reja nga Qeveria. Unë i them “jo, nuk është paraparë asnjë ndihmë për personat me nevoja të veçanta”. Më shikoi e pikëlluar dhe në heshtje tha: “Sikurse deri tani, kështu edhe tani e tutje, neve na harruan plotësisht, sikur të jemi të padukshëm, sikur të mos ekzistojmë”.



Raportim etnik dhe politik për Covid 19!

Sefer Tahiri, profesor universitar



Muajt e fundit, bota, përveç se me Covid 19, po përballet edhe me lajmet e rreme, por edhe me instrumentalizimin politik/partiak të situatës së re me virusin. Fatkeqësisht, në vend mund të evidentohen edhe përmbajtje gazetareske në disa prej mediave, në të cilat detektohet edhe prirje etnike dhe njëanshmëri!

Avancimi i bashkëpunimit midis organizatave civile dhe mediave - bazë për raportimin e përmirësuar mediatik për personat me aftësi të kufizuara

Mr. Vllado Krstovski, OJQ “Poraka”

Roli i mediave është kyç në formësimin e perceptimeve publike, ndërsa aktorët e tjerë duhet t’i mbështesin mediat në zvogëlimin e diskriminimit në vend të shkaktimit ose nxitjes së tij.



DEBAT: ARSIMI DHE MEDIAT NË PËRBALLJEN ME DISKRIMINIMIN, GJUHËN E URREJTJES DHE STEREOTIPAT

Shumë herë problemet në shoqëri ndodhin për shkak të mungesës së fakteve dhe informacioneve për dallimet, për atë që të tjerët e mendojnë, grupet e ndryshme kulturore, por kjo është një mungesë edhe për sa i përket temave dhe zhvillimeve të përditshme.

Në mediat shumë shpesh ka mungesë të raportimit gjithëpërfshirës kur bëhet fjalë për çështje me interes publik. Roli kryesor i medias është të informojnë, ndërsa informacioni nënkupton paraqitje të fakteve. Sot kemi shërbime të verifikimit të fakteve dhe organizata civile që bëjnë thirrje për këtë, megjithëse, në thelb, kjo është përgjegjësi e redaksive. Sigurisht se gazetarët dhe mediat kanë të drejtë të paprekshme të politikës redaktuese, megjithatë nuk duhet kihet kompromise me faktet.

Nga ana tjetër, qytetarët të edukuar mediatikisht do të jenë në gjendje të kuptojnë vlerën e lajmeve, të njohin mesazhet që arrijnë deri te ata, të ndërtojnë një qëndrim kritik dhe të gjykojnë në mënyrë kritike gjatë marrjes së vendimeve informuese.

Edukimi mediatik nënkupton mundësimin e një mjedisi ku nevojiten informacione të sakta, gjithëpërfshirëse, në kohë dhe të drejta. Publiku që di të njohë përmbajtje të tilla mediatike do të fitojë më shumë besim dhe lojalitet ndaj mediave që plasojnë ato përmbajtje. Kjo ndërkaq çon drejt shikueshmërisë më të lartë, onlajn vizitueshmërisë ose lexueshmëri më të lartë.

Hulumtimet tregojnë se temat që lidhen me mediat, ndikimin e tyre dhe përdorimin e përgjegjshëm të rrjeteve sociale, nxënësit i njohin si të dobishme. Për të pasur njohuri



dhe aftësi të mjaftueshme për të njohur informacione të besueshme dhe të rëndësishme mediatike, t'i përdorin mediat dhe të krijojnë produkte mediatike, nevojiten që përmbajtjet për edukim mediatik të përfshihen në shumë lëndë të ndryshme në arsimin fillor, të mesëm dhe të lartë.

Për këto tema u diskutua në debatin “Roli i mediave dhe arsimit në adresimin e diskriminimit dhe të gjuhës së urrejtjes”, që u mbajt më 21 tetor të vitit 2020.

[Shikoni pikat nga debati](#)



“Qytetarët mediatikisht të edukuar dinë të kuptojnë vlerën e lajmeve, t'i njohin mesazhet që vijnë deri te ata, të ndërtojnë një qëndrim kritik. Rrjedhimisht, është e nevojshme që vazhdimisht të investohet në përmirësimin e aftësive të qytetarëve për analizë kritike të përmbajtjeve mediatike”.

Mr.Dejan Andonov, Instituti i Studimeve të Komunikimit





“Njerëzit janë në të ashtuquajturat ‘fluska’ sepse zgjedhin se nga ku do të informohen, çfarë do të mbajnë mend, ngase një gjë e tillë korrespondon me bindjet e tyre të mëparshme. Edukimi mediatik është me rëndësi të jashtëzakonshme, ndërsa përvojat tregojnë se është më mirë nëse ai futet përmes përmbajtjeve të ndryshme mësimore në arsim”.

Snezhana Trpevska, kryetare e Institutit RESIS

“Publiku duhet të ketë dituri të mjaftueshme për të njohur se çfarë është e mirë dhe çfarë është e keqe, çfarë duhet të dëgjojë dhe çfarë jo. E gjithë kjo mund të arrihet nëse sigurojmë hapësirë të mjaftueshme në sistemin tonë arsimor. Sistemi ynë ka nevojë për një reformë të thelluar, ndërsa në ato reforma nuk kemi pasur sukses nëse mediat nuk i vendosim në vendin ku duhet të jenë”.

Naser Miftari, profesor në shkollë të mesme

“Të mendohet për inkuadrimit e edukimit mediatik në arsimin e lartë. Me fakultetet që ndërtojnë kuadrin mësimdhënës në fusha të ndryshme - Pedagogjik, Filologjik, Filozofik, Fakultetin Matematiko-natyror, ndërsa studentët e të cilëve pas diplomimit duhet të ligjërojnë nëpër shkolla, të bisedohet në drejtim të asaj se si të përvetësohen shkathtësitë për edukim mediatik gjatë studimit”.

Liljana Pecova Ilieska, anëtare e Komisionit të Ankesave pranë KEMM

“Pavarësisht fluksit të mediave dhe teknologjive të reja, ka rritje të analfabetizmit, jo- kulturës mediatike, zhargoneve deri në vulgaritete, prani të fyerjeve, të pavërteta të ashpra, fakte të shtrembëruara, konstatime arbitrare ... Mediat duhet të kenë rolin kryesor jo vetëm në informim, por edhe në shpartallimin e gjuhës së urrejtjes, diskriminimit dhe stereotipave”.

Jasmina Mironski, gazetare dhe profesoreshë universitare

“Pa ekzistimin e shkollave të dikurshme të redaksive, gazetarët më të rinj janë të kufizuar që nga vet fillimi i karrierës së tyre që ta njoftojnë realisht, për nga përvoja, se çfarë do të thotë gazetaria si profesion”.

Zoran Fidanoski, gazetar



Blogje...



Mediat dhe shkollat, thelbësore për parandalimin e gjuhës së urrejtjes, e më së shumti në rrjetet sociale


Vane Trajkov, gazetar

Jo vetëm të publikohet, por edhe t'u kushtohet vëmendje komenteve në rrjetet sociale pas postimit të informacioneve, sepse ato do të shkojnë në plan të dytë, ndërsa në sipërfaqe do të dalë liria e madhe e fjalës, me shumë komente fyese dhe gjuhë të urrejtjes që mund të shkaktojë pasoja të mëdha.

Arsimi në funksion të raportimit të drejtë mediatik

Nastasija Stojanoviq, Qendra Maqedonase për Arsim Qytetar

Të rinj të motivuar dhe të arsimuar, të cilët njohin rolet e tyre në shoqëri, janë çelësi i ndryshimeve pozitive në të tashmen, por edhe në të ardhmen. Shumë shpesh dëgjojmë se të rinjtë janë e ardhmja, por që të jenë shtytës të ndryshimeve pozitive në të ardhmen, ata duhet të jenë që sot qytetarë të përgjegjshëm dhe aktivë. Rolin më të rëndësishëm në këtë proces e ka arsimi dhe gëzohem që ky rol edhe njihet.




DEBAT: BASHKËPUNIM PËR ADRESIM EFEKTIV TË PROBLEMIT ME GJUHËN E URREJTJES DHE DISKRIMINIMIT NË MEDIAT

Në ballafaqimin me gjuhën e urrejtjes dhe diskriminimin është i nevojshëm një bashkëpunim ndër-sektorial të të gjithë aktorëve të rëndësishëm - Këshillit të Etikës në Mediat e Maqedonisë (KEMM), Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audio-Vizuale (ASHMAA), Avokatit të Popullit, Komisionit për Parandalimin dhe Mbrojtje nga Diskriminimi të Kuvendit të RMV-së, Prokurorisë Publike, gjykatave dhe policisë.

Duhet të ekzistojë një sistem i ndërsjellë dhe i informatave kthyesë, përmes të cilit, për shembull, Prokuroria Publike, gjykatat dhe institucionet e tjera kompetente do të informojnë ASHMAA çfarë kanë marrë lidhur me kërkesat që Agjencia i drejton për veprim. Edhe pse ekziston një kornizë ligjore dhe institucionale përmes së cilës do të kryhet parandalimi, monitorimi, kontrolli dhe sanksionimi i gjuhës së urrejtjes dhe krimit nga urrejtja, shteti përmes organeve të veta duhet të krijojë një sistem adekuat për monitorimin dhe raportimin e tyre. Duhet të mundësohet një sistem i ndihmës juridike falas për viktimat duhet të punohet në ngritjen e vetëdijes publike të qytetarëve. Gjithashtu, vazhdimisht të realizohen trajnime për punonjësit e policisë, prokurorive dhe gjykatave - shërbime që janë më të referuara dhe që janë direkt të ekspozuara me këto vepra penale.

Këto janë disa nga propozimet që u përmendën në debatin “Ndërlidhja midis organit vet-rregullues, rregullatorit të mediave radiodifuzive dhe avokatit të popullit në mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe reagimit ndaj gjuhës së urrejtjes në mediat”, që u mbajt më 20 nëntor të vitit 2020.

Shikoni pikat nga debati



“

“Gjuha e urrejtjes nuk është vetëm shkelje e standardeve gazetareske, por edhe vepër penale dhe mund të nxisë edhe krim nga urrejtja. Duke parë drejt gjuhës së urrejtjes në mediat si një problem shoqëror, është e nevojshme përfshirja e të gjithë aktorëve për shpërbërjen e saj, përfshirë edhe instrumentet e shtetit, respektivisht ndëshkimin dhe sanksionimin e kësaj dukurie”.

Katerina Sinadinovska, kryetare e KD të KEMM

“KEMM është organizatë që nuk shqipton dënime, por vendime me përmbajtje morale dhe betejën që po e bëjmë me gjuhën e urrejtjes dhe diskriminimit, në baza të ndryshme, mund të bashkohet me përpjekjet e Ombudsmanit për bashkëpunim, pikërisht në pikëpamjen e shkeljeve të të drejtave të njeriut”.

Mirçe Adamçevski kryetari i Komisionit për Ankesa pranë KEMM

”



“Gjuha e urrejtjes është një nga fushat e rëndësishme ku ASHMAA mund të bashkëpunojë me KEMM. Pas ndryshimeve të LASHMAA të vitit 2018, u krijua praktika që të gjitha raportet nga mbikëqyrjet për nenin 61 dhe masat e shqiptuara, t’i dërgohen KEMM, që të shqyrtohen nga Komisioni për Ankesa në aspektin e respektimit të Kodeksit të Gazetarëve. Pikërisht veprimi në raste të tilla, është pika në të cilën duhet të dakordohemi për një bashkëpunim më të mirë, mbase edhe në kuptimin e asaj kur në Agjenci të arrijnë parashtresa të tilla ose përmes detyrës zyrtare do të vërejë përmbajtje problematike që të mos analizojë ASHMAA, por menjëherë gjithçka t’i dërgohet KEMM”.


*Emilija Petreska-Kamenjarova,
Agjencia për Shërbime Mediatike Audio dhe Audio -Vizuale*

“Në rastet ku ka elemente të gjuhës së urrejtjes, Avokati i Popullit është i penguar të veprojë drejtpërdrejt, para se gjithash sepse është fjala për materie penale, ndërsa njëkohësisht edhe për shkak të mungesës së përgjegjësisë për të vepruar ndaj subjekteve të sektorit privat, që në shumicën e rasteve janë kryerës të gjuhës së urrejtjes, ose u mundësojnë individëve t’i përdorin bazat e tyre për të plasuar gjuhën e urrejtjes. Këtu, mbi të gjitha, do të aludoja në mediat dhe portalet, ku gjuha e urrejtjes është më e theksuar dhe ku kemi reaguar më shumë herë në mënyrë indirekte, respektivisht duke parashtruar kërkesa të caktuara me vërejtje deri te KEMM që të veprojë në përputhje me kompetencat e veta”

*Marijan Ponjaviq,
këshilltar shtetëror te Avokati i Popullit*



Blogje...



[Kur institucionet të qetësohen - dominon gjuha e urrejtjes](#) *Dragan Sekullovski, drejtor i SHGM-së*

Organizatrat civile që punojnë në promovimin e të drejtave të njeriut, si edhe ato në sektorin e medias, rregullisht iniciojnë debate publike për rrezikun nga gjuha e urrejtjes dhe pasojat kur ajo nuk sanksionohet. Rrallë, e ndoshta kurrë, këto tema nuk hapen publikisht nga institucionet e pushtetit ekzekutiv ose gjyqësorit. Pse është kjo kështu?

KEMM, ASHMV dhe Avokati i Popullit duhet të kenë një sinergji të ndërsjellë për çrrënjosjen e gjuhës së urrejtjes dhe diskriminimit

Zoran Fidanoski, gazetar, anëtar i Këshillit të ASHMV

Cilat janë pikat për të cilat mund të arrihet sinergji ndërmjet rregullatorit të mediave elektronike, organit vet-rregullues dhe Ombudsmanit? Ekzistojnë disa, por është e sigurt se gjuha e urrejtjes dhe diskriminimi është më e rëndësishmja mes tyre.



Dënime, por edhe edukim mediatik kundër gjuhës së urrejtjes

Mr. Dejan Andonov, Instituti i Studimeve të Komunikimeve




Hapësira onlajn dhe mediat sociale janë bërë vendet qendrore ku të rinjtë eksplorojnë ide të reja, shprehin identitetin e tyre dhe marrin pjesë në shoqërinë më të gjerë. Por, në të njëjtën kohë, mund të keqpërdoren nga ata që duan t'i përdorin për nënçmim, fyerje dhe ngacmim. Dispozitat ndëshkuese më nuk janë të mjaftueshme për t'u penguar gjuha e urrejtjes, por janë të nevojshme edhe masa edukative për zgjidhjen e këtij problemi shoqëror.



KUNDËR STEREOTIPAVE DHE DISKRIMINIMIT ME RAPORTIM MEDIK GJITHËPËRFSHIRËS

Gazetaria gjithëpërfshirëse është një përmbledhje gjykimesh me vlerë (mendime, besime dhe emocione), politikash redaktuese dhe praktikash të raportimeve që synojnë të sigurojnë përfshirjen e zërave të ndryshëm në sferën e medias. Gazetaria gjithëpërfshirëse duhet të sigurojë një rishikim të punës dhe procedurave specifike që realizojnë gazetarët, në mënyrë që të ofrojnë zgjidhje dhe përgjigje ndaj pabarazive që janë rezultat i mosfunksionimit të duhur të strukturave shoqërore. Këtë e theksoi Vesna Nikodinoska nga Instituti Maqedonas i Mediave, në punëtorinë “Kundër stereotipave dhe diskriminimit me raportimin mediatik gjithëpërfshirës”, që u mbajt më 18 Janar të vitit 2021.


[Shikoni pikat kryesore të punëtorisë](#)



ME NJË POLITIKË REDAKTUESE TË QARTË DHE TË THEKSUAR KUNDËR GJUHËS SË URREJTJES, DISKRIMINIMIT DHE DEZINFORMIMEVE

Mosnjohja e rreziqeve nga keqpërdorimi i gjuhës së urrejtjes dhe përdorimi i gjuhës së urrejtjes, madje edhe në rrjetet sociale, mund të shkaktojnë tensione shoqërore që do të prishnin rendin dhe paqen publike. Kjo ishte një nga temat e punëtorisë “Roli i redaksive në parandalimin e gjuhës së urrejtjes, diskriminimit dhe dezinformimit”, që u mbajt më 8 shkurt të vitit 2021.

[Shikoni pikat kryesore të punëtorisë](#)



“

“Gazetaria gjithëpërfshirëse duhet të sigurojë mendim reflektues për proceset në shoqëri, të përfshijë pluralizmin shoqëror, politik dhe kulturor, të njohë dhe të pranojë dallimin”.

Vesna Nikodinoska, Instituti Maqedonas i Mediave

”

““

“KEMM ka një traditë që do të vazhdojë të shpërblejë gazetarinë profesionale, veçanërisht atë kushtuar raportimit gjithëpërfshirës, sepse besohet se mediat mund të ndihmojnë në kapërcimin e këtyre llojeve të problemeve me hapjen e pikërisht çështjeve të tilla para opinionit. Padyshim, duhet të punohet në përgatitjen e udhëzimeve dhe standardeve shtesë, se si të raportohet për këto grupe shoqërore.”

Marina Tuneva, drejtoreshë ekzekutive e KEMM

“Çfarë mund të bëjnë mediat?” Ato, fillimisht, duhet kryesisht të luftojnë paragjykimet në publik se personat me aftësi të kufizuara janë të paaftë dhe të pafuqishëm. Produktet mediatike përmes një qasjeje afirmative, të lirë nga sensacionalizmi, dramatizimi dhe dhembshuria, duhet t'i paraqesin ata si persona që mund të kontribuojnë në të gjitha fushat e jetës, me çka edhe do të promovojnë një shoqëri më gjithëpërfshirëse dhe me vetë këtë, një shoqëri më tolerante”.

Vllado Krstevski, Qendra Republikane për Personat me Aftësi të Kufizuara Intelektuale “Poraka”

“Barazia joreale është një kategori që e hasim shumë shpesh. Në mediat do të vërehet edhe një prani e ekuilibruar e burrave dhe grave, por nëse i shikoni në më shumë detaje sipas rubrikave, do të vëreni se në ballinat ose në fillim në rubrikat kryesore - politikë, ekonomi, Maqedoni dhe botë, dominojnë burrat, ndërsa nga mesi deri në fund, ku janë të vendosura informacionet për kulturë, estradë, argëtimin dhe skenë, në shumicën absolute janë gratë. Numri është i njëjtë, por thelbi është larg tij.

Irena Cvetkoviç, Koalicioni “Margjinat”

“Ne jemi përqendruar kryesisht në ngjarje ditore-politike, me të cilat duhet të plotësohen lajmet ose hapësirat në gazeta dhe mediat onlajn. Por, kur bëhet fjalë për një temë të tillë, atëherë kjo është pak më komplekse, veçanërisht nëse bëhet fjalë për një produkt televiziv në të cilin duhet të kapet e gjithë storja. Dhe veçanërisht sepse mënyra e prezantimit në vet mediat luan një rol kryesor në perceptimin publik për një grup të caktuar.”

Petar Klinçarski, gazetar në “360 gradë”

”

““

“Urrejtja, intoleranca, mungesa e ndjenjës së përgjegjësive për atë që thuhet, sot janë shumë më të pranishme se më parë. Kjo situatë pasqyrohet nga një media sociale në tjetrën, e më pas edhe në mediat tradicionale. Pavarësisht se sa shpjegoni se çfarë është gjuha e urrejtjes përkundrejt lirisë së shprehjes, e madje edhe po t’i lusni shikuesit të jenë të kujdesshëm në lidhje me komunikimin, kjo do të zgjasë një ose dy javë. Pastaj, ndodh e njëjta gjë, e ju duhet sërish të ‘përcillni’ komunikimin”.

Ognen Janeski, gazetar dhe udhëheqës i një emisioni kontaktues

“Dezinformimet sot mund të plasohen shumë më lehtë, sepse më herët kishte filtra - redaktorë, ndërsa tani çdo dëgjues, shikues, lexues duhet të jetë redaktori i vetvetes. Sidoqoftë, kjo kërkon njohuri, edukim, duhet të ndiqet gjithçka që ndodh, të kihet para-informacion, kontekst”.

Stole Naumov, redaktor dhe udhëheqës i emisionit kontaktues “Stadium” - Radio Kanal 77

“Kolegët moderojnë të gjitha komentet në Facebook, YouTube dhe në rrjetet sociale dhe analizojnë komentet e përdoruesve, veçanërisht ato që përmbajnë fyerje dhe nënçmime. Praktikisht, po përballemi me një problem nga brezat e rinj të cilët publikisht, me emër dhe mbiemër, përhapin të gjitha llojet e informacioneve, lajme të rreme, gjuhë të urrejtjes”.

Dimitar Micev, TV Vis – Strumicë

“Kur ka mungesë të një politike të qartë dhe të spikatur redaktuese, e cila nënkupton sundim të standardeve etike, është ky ‘flamuri i kuq’ që tregon për përmbajtje të dyshimtë. Rregulli i parë që mësohet është që duhet të konsultosh të dy palët. Por si kjo pasqyrohet tek ne? Gazetari do të pyesë njërin dhe palën tjetër dhe neve do të na prezantojë një kontribut me dy faqe. Po ku është tema, ku është çështja për të cilën po diskutojmë? Gazetarët shumë shpesh nuk na shpjegojnë sa duhet në lidhje me çështjen, nuk na japin fakte të mjaftueshme për të vlerësuar se cila palë ka të drejtë”.

Santa Argirova, gazetare

”



“Qendra të caktuara të fuqisë politike mund të keqpërdorin emisionet kontaktuese që të krijojnë përshtypjen se zëri i njerëzve është pro ose kundër një teme të caktuar, varësisht nga interesi i tyre. Për këtë arsye, duhet të zgjidhen me kujdes temat, sepse audienca nuk mund të jetë kompetente për çdo temë që hapet. Është e rëndësishme të zbulohet edhe nëse një emision i caktuar nxit mendimin e lirë të qytetarëve ose mundëson plasimin e propagandës partiake dhe organizimin e anëtarësisë partiake të paraqitet dhe të mbështesë qëndrime të caktuara”.

Xhelal Neziri, Qendra për Gazetari Hulumtuese-SCOOP



Blogje...



Media dhe personat me aftësi të kufizuara - Inkluzion në botën e ekskluzivitetit


Vesna Ivanovska-Ilievska, gazetare

Për ekspozitat e artistes Afërdita Kiki, kam shkruar një sërë njoftimesh, të gjitha të botuara në faqen e kulturës të gazetës “Dnevnik”, ku kam punuar për 17 vite. Gjithmonë më kanë pëlqyer veprat e saj. Por, ja që assesi nuk na rastisi të takoheshim dhe të flisnim për veprimtarinë e saj. U takuam rastësisht, në ndarjen e disa çmimeve. Kishte kohë që nuk kisha takuar një person me një energji kaq mbresëlënëse. E fuqishme, por pafundësisht e butë. Sikur ta kisha njohur tërë jetën. Mezi i vërejta patericat.

Në media flasin një numër i kufizuar i politikanëve dhe ekspertëve

Erdem Ahmet, gazetar, anëtar i Komisionit të Ankesave të KEMM

“Mos ua bëj të tjerëve atë që nuk dëshiron të ta bëjnë ty”. Po qe se mediat do të kishin ndjekur këtë mendim të mençur të Konfucit, nuk do të kishte pasur përmbajtje me gjuhë urrejtjeje, paragjykime, gjuhë diskriminuese dhe stereotipa që lidhen me dallimet. Do të kishte debate dhe mosmarrëveshje si edhe tani, por do të kihej kujdes sa i përket fjalëve.





Si të përballemi me gjuhën e urrejtjes në rrjetet sociale

Monika Aksentievskaja, Instituti i Studimeve të Komunikimit

Rrjetet sociale ndryshuan mënyrën se si informohemi, duke na mundësuar një qasje të shpejtë dhe të lehtë deri te informacionet. Gjithashtu na dhanë edhe një platformë për shprehje të lirë dhe nxitje të ndryshimeve shoqërore. Nga ana tjetër, ndërkaq, liria për të qenë secili krijues i përmbajtjeve, zbuloi disa nga aspektet negative të rrjeteve sociale, sikurse përhapja e dezinformatave dhe gjuhës së urrejtjes, maltretimit onlajn, mashtrimeve, etj.

Redaktorët - faktor thelbësor kundër gjuhës së urrejtjes

Arta Tahiri, redaktore e lajmeve dhe e emisionit "Rruga drejt" në TV Alsat M


Gjuha e urrejtjes është e pranishme jo vetëm në mediat onlajn, ose siç quhen në mënyra të popullarizuar portale, në internet hapësirën dhe rrjetet sociale, por edhe në televizion, radio, mediat e shkruara, në fjalime politike dhe adresime të tjera publike, në tubimet publike – mitingje, protesta dhe në garat sportive.



Fjala e thënë mund të vrasë më shumë se më parë

Dragan Sekullovski, drejtor ekzekutiv i Shoqatës së Gazetarëve të Maqedonisë

Aksioma se "fjala e thënë mund të vrasë" nuk ka mundur të hidhej poshtë në debatin filozofik në histori, ndërsa nga këndvështrimi i sotëm, duke marrë parasysh progresin e informacionit dhe globalizimin, rreziku i keqpërdorimit të lirisë së shprehjes dhe prishjes së sigurisë së njerëzve është më i madh se kurrë më parë.





www.semm.mk